VENDIM
Nr.827, datë 11.12.2003

PËR MËNYRËN E KODIMIT DHE STRUKTURËN E NUMRIT TË IDENTITETIT TË SHTETASVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8951, datë 10.10.2002 "Për numrin e identitetit të shtetasve", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mënyra e kodimit dhe struktura e numrit të identitetit të shtetasve (NISH) të jenë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zyrat e gjendjes civile në bashki, njësitë bashkiake të Tiranës dhe komunat, duke filluar nga data 1 janar 2004, të raportojnë lindjet në Drejtorinë e Regjistrit Kombëtar në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, sipas periudhave kohore të vendosura nga kjo ministri.

3. Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, pas caktimit të NISH-it, të dërgojnë numrat e identitetit të shtetasve në zyrat përkatëse të gjendjes civile në bashki, në njësitë bashkiake të Tiranës dhe në komuna, të cilat janë të detyruara t'i shënojnë këta numra në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile.

4. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe zyrat e gjendjes civile në bashki, njësitë bashkiake të Tiranës dhe komuna për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneks 1

STRUKTURA E NUMRIT TË IDENTITETIT TË SHTETASVE

Numri i identitetit të shtetasve (NISH) përbëhet nga 10 (dhjetë) elemente të strukturuara si më poshtë:

Elementi 1-2	Viti i lindjes
Elementi 3-4	Muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6	Data e lindjes
Elementi 7-9	Numri serial brenda të njëjtës datë
Elementi 10	Element kontrolli

A. Elementet 1 dhe 2 tregojnë vitin e lindjes dhe ndërtohen si më poshtë:

Tabela 1

Shekulli i 19-të	Shekulli i 20-të	Shekulli i 21-të
00-09 – 1800-1809	A0-A9 – 1900-1909	K0-K9 – 2000-2009
10-19 – 1810-1819	B0-B9 – 1910-1919	L0-L9 – 2010-2019
20-29 – 1820-1829	C0-C9 – 1920–1929	M0-M9- 2020-2029
30-39 - 1830-1839	D0-D9 – 1930-1939	N0-N9 – 2030-2039
40-49 – 1840-1849	E0-E9 – 1940-1949	O0-O9- 2040-2049
50-59 – 1850-1859	F0-F9 – 1950-1959	P0-P9 – 2050-2059
60-69 – 1860-1869	G0-G9 – 1960-1969	Q0-Q9 – 2060-2069
70-79 – 1870-1879	H0-H9 – 1970-1979	R0-R9 – 2070-2079
80-89 – 1880-1889	I 0-I 9 – 1980-1989	S0-S9 – 2080-2089
90-99 – 1890-1899	J 0-J 9 – 1990-1999	T0-T9 – 2090-2099

B. Elementet 3 dhe 4 tregojnë muajin e lindjes dhe gjininë. Për personat e gjinisë mashkullore muaji shënohet siç është (nga 1-12) dhe për personat e gjinisë femërore i shtohet numri 50. Kjo ndërtohet si më poshtë:

Tabela 2

Muajt	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
Janar	01	51
Shkurt	02	52
Mars	03	53
Prill	04	54
Maj	05	55
Qershor	06	56
Korrik	07	57
Gusht	08	58
Shtator	09	59
Tetor	10	60
Nëntor	11	61
Dhjetor	12	62

C. Elementet 5 dhe 6 tregojnë datën e lindjes nga 01 deri në 31 të një muaji. Elementi 5 është një numër nga 0 deri në 3, sipas rastit dhe elementi 6 është një numër nga 0 deri në 9 sipas rastit.

D. Elementet 7, 8 dhe 9 përbëjnë një numër të vetëm dhe të renditur nga 001 në 999 dhe shërben për numërimin e personave të lindur në të njëjtën datë. Ky numër gjenerohet në momentin e regjistrimit të të dhënave vetjake të personit në fjalë, në Drejtorinë e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

E. Elementi 10 është një shkronjë dhe shërben si element kontrolli që gjenerohet si më poshtë:

1. Elementi i parë konvertohet me numrin e pozicionit të shkronjës sipas tabelës 3.

Tabela 3

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	0
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	W

2. Numrat e elementeve 2 deri në 9 shumëzohen me numrin që tregon pozicionin e elementit. Kështu, numri aktual në elementin 2 shumëzohet me 2, numri aktual në elementin 3 shumëzohet me 3, numri aktual në elementin 4 shumëzohet me 4 etj.

3. Rezultatet e nxjerra nga veprimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2 mblidhen dhe rezultati përfundimtar pjesëtohet me numrin 23.

4. Numri që rezulton si mbetje konvertohet me shkronjë sipas tabelës 3. Kjo shkronjë përbën elementin 10.